



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika b.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 35 paragrafi 2 pika b) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2015 aprovon këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VITISË
PËR VITIN 2016-2018

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2016-2018.

Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 është në shumë prej 9,487,984€. Buxheti për vitin 2017 është në shumë prej 9,572,617€. Buxheti për vitin 2018 është në shumë prej 9,674,526€.

Burimet e buxhetit janë: Të hyrat nga Grandi Qeveritar dhe nga të hyrat vetanake komunale.

Neni 2

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2016 janë:

a) Të hyrat nga Grandi Qeveritar	8,548,484€
b) Të hyrat vetanake komunale	939,500€

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2017 janë:

c) Të hyrat nga Grandi Qeveritar	8,613,117€
d) Të hyrat vetanake komunale	959,500€

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2018 janë:

e) Të hyrat nga Grandi Qeveritar	8,690,026€
Të hyrat vetanake komunale	984,500€

Neni 3

Buxheti për vitin 2016 shpërndahet në këto kategori ekonomike :

Paga e mëditje.....	6,677,482€
Mallra e shërbime	899,991€
Shpenzime komunale	200,862€
Subvencione dhe transfero	197,712€
Shpenzime kapitale.....	1,511,937€

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela e planit të buxhetit 4.1,4.2 dhe 4.3 të sistemit BDMS –së dhe PIP-a.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa
2. Shërbimit të Kuvendit
3. Arkivit

